



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 238 prot.

Tiranë, më 01.03.2026

NJOFTIM
PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT “TISH DAIJA”
Në 100-vjetorin e lindjes së Mjeshtrit të Madh të Muzikës

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, ligjin nr.35, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall konkursin “Tish Daija” - Në 100-vjetorin e lindjes së Mjeshtrit të Madh të Muzikës.**

Kategoritë e krijimtarisë së kërkuar:

1. Vepër vokale për solist dhe korin e Ansamblit Popullor a cappella

(Mbështetur mbi një motiv apo material të traditës së këngëve epike apo legjendave shqiptare)
Kohëzgjatje 3 – 5 minuta

2. Vepër vokale për solist, kor dhe orkestrinën e Ansamblit Popullor

(Mbështetur mbi një motiv apo material popullor) **Kohëzgjatje 3 – 5 minuta**

3. Këngë popullore të përpunuar për solist, kor dhe orkestrinën e Ansamblit Popullor

(Përpunimi mund të jetë versioni solistik i një kënge popullore qytetare **3 – 5 minuta**, ose një kolazh popullor me më shumë se dy këngë **4 – 6 minuta**, ku mund të përfshijë përpunimin dhe lidhjen e disa këngëve popullore nga një krahinë e caktuar ose disa krahina të ndryshme).

Përmbajtja e formacionit instrumental të Orkestrinës së Ansamblit Popullor për veprat të Kategorisë 2 dhe 3 është si më poshtë:

- Fizarmonikë (1)
- Lahuta (2)
- Kontrabas (1)

- Klarinetë (2)
- Oboe (1)
- Flaut (1)
- Violina (2)
- Dajre, Lodër

Përmbajtja e formacionit koral:

- Soprano
- Alto
- Tenor
- Bariton

Kushtet e pjesëmarrjes:

1. Pjesëmarrësit duhet të jenë shtetas shqiptarë.
2. Çdo krijues duhet të paraqesë maksimumi 1 (një) vepër për secilën kategori të krijimtarisë së kërkuar.
3. Çdo krijues mund të shpallet fitues me maksimumi 2 (dy) krijime apo 2 (dy) përpunime nga të gjitha kategoritë e kërkuara.
4. Të gjitha krijimet apo përpunimet duhet të mbështeten thellësisht në motivet popullore shqiptare dhe harmonizimet përkatëse.

6. Krijimi duhet të dorëzohet në formatet e mëposhtme:

- Partiturë e plotë digjitale full score (e notizuar në format elektronik).
- Partitura solistike për çdo instrument të orkestrinës.
- Partitura vokale për solist dhe kor (me tekstin në partiturë).
- Version audio (MIDI / projekti për dëgjim).
- File e partiturës nga programet Sibelius, Finale, Dorico etj.
- Audio në formatin *mp3* për dëgjim.

7. Çdo krijues i interesuar duhet të plotësojë pranë sekretarisë së TKOBAP-së, formularin e regjistrimit për konkursin si dhe dokumentacionin përkatës (CV artistike, fotokopje e kartës së identitetit) të cilat duhet t'i bashkëngjiten dosjes së dorëzimit.

Përzgjedhja e fituesve

Krijimet do të përzgjidhen nga një grup i përbërë nga personalitete të artit dhe muzikës duke përzgjedhur nga e gjithë krijimtaria e paraqitur në komision vetëm **10 vepra**.

- Dy krijime vokale për solist dhe kor a cappella (3 – 5 minuta secila)
- Katër krijime për solist, kor dhe orkestrinën e Ansamblit Popullor (3 – 5 minuta secila)
- Katër përpunime këngësh të vjetra popullore për solist, kor dhe orkestrinën e Ansamblit Popullor
(Përpunimi mund të jetë versioni solistik i këngë popullore 3 – 5 minuta, ose në formën e një kolazhi popullor me më shumë se dy këngë 4 – 5 minuta)

Veprat e përzgjedhura do të interpretohen në një koncert premierë nga trupa e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore në Festivalin “Netët e Muzikës Shqiptare”

Të drejtat e autorit do të zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Në rast se vepra/t muzikore kualifikohet/n apo shpallet fituese, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, ka të drejtën e plotë për përdorimn dhe vënien në skenë të veprës origjinale dhe të prejardhur që do të ekzekutohet.

Për rregullimin e marrëdhënieve mbi të drejtën e autorit palët do të nënshkruajnë një marrëveshje midis krijuesit të veprës dhe TKOBAP, për termat dhe rregullimin e mënyrës së përdorimit të veprës.

Afati i dorëzimit të materialeve është ditën e enjte, datë 8 maj, ora 16:00 pranë sekretarisë së teatrit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aulon Naci

